



## *fq. 2* AMF zhvillon konferencën “Sistemi i pensioneve vullnetare në Shqipëri - zgjerimi i mbulimit”

### VËSHTRIM MBI TREGJET

- » Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shtator 2015 fq. 3
- » Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2015 fq. 4

### ZHVILLIME TË TJERA

- » Zhvillohet forumi global mbi pensionet private dhe mbledhja e përgjithshme vjetore e IOPS-it fq. 6
- » Takimi i nëntë i mbikëqyrësve të tregjeve të sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore fq. 7
- » Seminar rajonal për mbikëqyrësit lidhur me praktikatat e mbikëqyrjes me bazë rrisht dhe ndërhyrjen e hershme fq. 7
- » Seminar mbi zbatimin parimeve të IOSCO-s fq. 8
- » Konferencë mbi rritjen e kapaciteteve për mbrojtjen e konsumatorit fq. 9
- » Konferencë mbi edukimin dhe mbrojtjen e investitorëve: Sfidat kryesore që hasen përpara fq. 9

### LAJMET NGA RAJONI

- » Azerbajxhan fq. 11
- » Kroaci fq. 11
- » Moldavi fq. 11

### EDUKIMI I KONSUMATORIT

- » “E ardhmja e tregjeve të kapitalit në ekonominë dixhitale” fq. 12  
Greg Medcraft, Kryetar i Komisionit të Letrave me Vlerë dhe Investimeve të Australisë  
(Pjesa e parë)

## Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

## AMF zhvillon konferencën “Sistemi i pensioneve vullnetare në Shqipëri - zgjerimi i mbulimit”



*Zj. Enkeleda Shehi, Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrje Financiare gjatë fjalës së saj në konferencë*

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me mbështetjen e Bankës Botërore, në kuadër të zbatimit të projektit “Mbikëqyrja dhe mbulimi i pensioneve”, me fonde të Iniciativës FIRST zhvilloi në datën 8 tetor 2015 konferencën “Sistemi i pensioneve vullnetare në Shqipëri - zgjerimi i mbulimit”. Në të u diskutua nga ekspertët, mbikëqyrësit, punëdhënësit dhe sektori i pensioneve private, për nevojën e zhvillimit të mëtejshëm të pensioneve vullnetare private në Shqipëri. Ndër folësit kryesorë ishin Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Z. Blendi Klosi, Menaxherja e Zyrës së Bankës Botërore në Shqipëri, Zj. Tahseen Sayed, dhe Zëvendësministrja e Financave, Zj. Irena Beqiraj.

Në fjalën e saj, Zj. Enkeleda Shehi, Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, theksoi rëndësinë e përfundimit të ndryshimeve fiskale në mënyrë që të nxitet kursimi për pensionet private. Ajo theksoi rezultatet e anketimit të realizuar në bashkëpunim me INSTAT, i cili identifikoi disa sfida me rëndësi kritike, në veçanti, nevojën për të dhënë informacion të thjeshtë, i cili t'i ndihmojë punonjësit dhe punëdhënësit ta kuptojnë përse janë të rëndësishme pensionet vullnetare dhe cilat janë përfitimet reale.

Në fjalën e saj, Zj. Tahseen Sayed, Menaxhere e Zyrës së Bankës Botërore në Shqipëri, theksoi se Qeveria e Shqipërisë po zbaton reforma të rëndësishme për pensionet publike. Qeveria po kërkon t'i përmirësojë më tej pensionet me këtë përpjekje të re për zgjerimin e mbulimit të pensioneve private. “Shqipëria ka nevojë të hedhë tani themelet e një sistemi të diversifikuar pensionesh, ku rëndësi kritike kanë si pensionet publike ashtu edhe ato private, për të kontribuar në sigurinë financiare për burrat dhe gratë pas daljes në pension,” - tha ajo.

Duke folur në konferencë Ministri i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Z. Blendi Klosi vlerësoi reformën në sistemin e pensioneve shtetërore dhe nxiti gjithëpërfshirjen edhe në skemat vullnetare të pensioneve. Ministri Klosi e vuri theksin tek të rinjtë dhe përfshirja e tyre gjithnjë e më e madhe në skemat e pensioneve.

Shoqëritë tregtare shqiptare që u kanë ofruar punonjësve të tyre pjesëmarrje në skema të pensioneve private vullnetare prezantuan përvojën e tyre dhe procesin e komunikimit që kanë ndërmarrë për të shpjeguar përfitimet që sjellin këto skema. Gjithashtu, tri shoqëritë e administrimit të fondeve të pensioneve që ushtrojnë aktivitet në Shqipëri prezantuan perspektivën e tyre në lidhje me zhvillimin e tregut, avantazhet e fondeve të pensioneve dhe mundësitë për zgjerim.

Disa prej ekspertëve rajonalë që merrnin pjesë në konferencë ofruan krahasime me vende dhe përvoja të tjera të mira. Ekspertët e huaj folën në konferencë për praktikatat më të mira në botë. Ata ndanë me pjesëmarrësit përvoja dhe ide se si të zgjerohet më tej tregu i pensioneve vullnetare private dhe si të rritet roli i autoritetit rregullator të këtij tregu në Shqipëri.

Në fjalën e saj mbyllëse, Zj. Shehi theksoi se kjo konferencë është fillimi i një procesi të vazhdueshëm për të cilin AMF është e angazhuar ta vijojë si një forum ku të diskutohet për pikëpamjet se si të realizohet një sistem i fuqishëm pensionesh në Shqipëri.

## VËSHTRIM MBI TREGJET

### Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shtator 2015

Tregu i sigurimeve u rrit me 17.27% gjatë periudhës janar-shtator 2015. Vlera e primeve të shkruara bruto në këtë periudhë arriti rreth 10.01 miliardë lekë. Kjo u shoqërua me rritje të numrit të policave të sigurimit me 7.17% duke arritur në 812,287 polica.

Një tjetër tregues i ecursisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 17.63% në krahasim me periudhën janar-shtator 2014. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 1.49 miliardë lekë, apo 63.55% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

### Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 20.11% gjatë periudhës janar-shtator 2015, krahasuar kjo me periudhën janar-shtator 2014.

### Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohen të kenë arritur vlerën rreth 6.10 miliardë lekë gjatë periudhës janar-shtator 2015, duke shënuar një rritje prej 21.38% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 60.69% të tregut të sigurimeve.

## Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 14.19% të tregut të Jo-Jetës;
- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme të cilat së bashku zunë 13.49% të tregut të Jo-Jetës.

## Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 9.41% krahasuar me periudhën janar-shtator të vitit 2014. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitor” e cila përbën 65.89% të sigurimit të Jetës.

## Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-shtator 2015

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.




## Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2015

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-shtator 2015 u dominua në masën 73.11% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (*bono thesari*) dhe pjesa tjetër prej 26.89% ishin instrumente afatgjatë (*obligacione*). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 84.90% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-shtator 2015 flasin për një dominim të transaksioneve “*Blerje në tregun primar*” dhe “*Shlyerje e vlerës nominale në maturim*” përkatësisht me 67.99% dhe 16.47% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekundar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 98.40% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

## Letra me Vlerë të Qeverisë janar-shtator 2015



## Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar” gjatë periudhës janar-shtator 2015, ka pasur një rritje prej 45.2 milionë lekë ose 0.84% krahasuar me janar-shtator 2014 dhe numri i transaksioneve është rritur në masën 6.37%.

Transaksioni i llojit C “Blerje para afatit të maturimit” gjatë periudhës janar-shtator 2015 ka pasur një ulje prej 319.86 milionë lekë ose 14.19% krahasuar me janar-shtator 2014, ndërsa numri i transaksioneve është ulur në masën 16.23%.

Krahasuar me janar-shtator 2014, vihet re një ulje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 274.66 milionë lekë.

## Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Lloji i Transaksionit	Vlera nominale		Ndryshimi
	(në mln lekë)		(në %)
Periudha janar-shtator	2014	2015	'15/'14-1
<b>B Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar</b>	<b>5,362.55</b>	<b>5,407.75</b>	<b>0.84</b>
<i>Individë</i>	4,273.69	4,386.50	2.64
<i>Persona juri dikë</i>	1,088.87	1,021.26	(6.21)
<b>C Blerje para afatit të maturimit</b>	<b>2,254.07</b>	<b>1,934.21</b>	<b>(14.19)</b>
<i>Individë</i>	2,034.01	1,860.81	(8.52)
<i>Persona juri dikë</i>	220.06	73.40	(66.65)

# ZHVILLIME TË TJERA

## Zhvillohet Forumi Global mbi Pensionet Private dhe Mbledhja e Përgjithshme Vjetore e IOPS-it

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Pensioneve, (*International Organisation of Pensions Supervisors, IOPS*) në bashkëpunim me Organizatën për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (*Organisation for Economic Co-operation and Development, OECD*) zhvilluan në datat 29-30 tetor, në Berlin, Gjermani, Forumin Global mbi pensionet private, "Tendencat në tregun e pensioneve dhe ndryshimet në peizazhin mbikëqyrës" (*Pension Trends and the Changing Supervisory Landscape*). Pjesëmarrës në Forum ishin zyrtarë nga autoritetet rregullatore dhe mbikëqyrëse, ekspertë të nivelit të lartë nga industria e fondeve private të pensionit dhe institutet kërkimore nga vendet anëtare të të dyja organizatave OECD dhe IOPS. Në këtë aktivitet merrte pjesë edhe Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë, si vend anëtar i IOPS-it.

Diskutimet në Forumin Global u fokusuan në një numër çështjesh rregullatore dhe mbikëqyrëse që ndikojnë në skemat e pensioneve private dhe publike, duke analizuar tendencat aktuale, arritjet dhe sfidat në procesin e reformave të sistemit të pensioneve. Prezantime u bënë duke marrë mjaft shembuj nga procesi i reformave të sistemit të pensioneve në Evropë, nga përfaqësues të autoritete të pensioneve dhe ekspertë nga Anglia, Austria, Finlanda, Gjermania, Holanda, Rumania, Turqia, Zvicra, etj. Qëllimi ishte identifikimi i praktikave më të mira dhe marrja e përvojave nga vendet anëtare të OECD dhe IOPS.

Tematikat kryesore të trajtuara në sesione lidheshin me:

- » Mënyrat e ristrukturimit të investimeve afatgjata të fondeve të pensionit në mjedisin e sotëm ekonomik. Folësit në sesion diskutuan politikën dhe sfidat rregullatore të mbikëqyrjes së fondeve të pensioneve që veprojnë në një ekonomi globale me norma të ulëta interesi;
- » Madhësinë e fondeve të pensionit dhe çfarë konsiderohet një fond i madh pensioni. Prezantuesit shpjeguan përvojat nga vendet e tyre se si kontribuojnë këto fonde të mëdha pensionesh në stabilitetin financiar të vendit dhe se si mund të mbrohesh nga rreziqe të mundshme;
- » Mbrojtjen e konsumatorit në tregun e pensioneve private vullnetare. Panelistët i kushtuan vëmendje rezultateve nga projektet e ndërmarra nga IOPS dhe diskutuan për rolin e autoriteteve mbikëqyrëse të pensioneve në mbrojtjen dhe edukimin e konsumatorëve;
- » Zgjidhjet e mundshme për fazën e pagesës së anëtarëve të fondeve të pensioneve. Këto diskutime u lidhën me mbledhjen e informacionit mbi sjelljen ekonomike, faktorët njohës dhe emocionalë që ndikojnë mbi vendimet ekonomike të konsumatorit në tregun e pensioneve dhe rrjedhojat që ato mund të kenë në këtë treg.

Krahas Forumit, u zhvilluan edhe Mbledhjet e Komiteteve Teknike dhe Ekzekutive të IOPS dhe Mbledhja e Përgjithshme Vjetore e IOPS-it. Në këto takime u prezantuan dhe u diskutuan reformat e ndërmarra në fushën e pensioneve private nga disa prej vendeve anëtare. Gjithashtu u miratua programi i punës dhe buxheti.

## Takimi i nëntë i mbikëqyrësve të tregjeve të sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore

Më datën 1 tetor në Trebinje, Bosnje-Hercegovinë, u zhvillua takimi i nëntë i mbikëqyrësve të tregjeve të sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (*Central, Eastern and South-Eastern European Insurance Supervision Initiative, CESEE*). Takimi u organizua nga Agjencia e Sigurimeve të Republikës së Bosnje-Hercegovinës.

Ky takim ishte strukturuar në katër pjesë dhe secili nga vendet pjesëmarrëse, me anë të përfaqësuesve të tij, ndau me të pranishmit eksperiencën për temat e axhendës.

Temat kryesore të këtij takimi ishin:

- » Kërkesat për përshtatmëri dhe aftësi të anëtarëve të Bordit Drejtues/Këshillit Mbikëqyrës të shoqërive të sigurimit;
- » Praktikrat në lidhje me mbikëqyrjen e ndërmjetësve në sigurime, si dhe ndryshimet në kuadrin rregullator të BE-së për këtë fushë;
- » Shkëmbimi i eksperiencave në lidhje me mbikëqyrjen në vend të shoqërive të sigurimit si dhe monitorimi dhe kontrolli i shoqërive audituese.

## Seminar rajonal për mbikëqyrësit lidhur me praktikrat e mbikëqyrjes me bazë rrisht dhe ndërhyrjen e hershme

Banka Kombëtare e Sllovakisë, në bashkëpunim me Shoqatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS) dhe Institutin e Stabilitetit Financiar (FSI) zhvilluan në datat 6-8 tetor 2015 në Bratislavë, Sllovaki, seminarin rajonal për mbikëqyrësit lidhur me praktikrat e mbikëqyrjes me bazë rrisht dhe ndërhyrjen e hershme.

Pjesëmarrësit në seminar ndanë eksperiencat e tyre dhe diskutuan për problemet kryesore të tregut të sigurimeve, duke prezantuar edhe raste studimore.

Gjatë këtij seminari u diskutuan tema të ndryshme si:

- » Mbikëqyrja me bazë rrisht dhe stabiliteti financiar nga perspektiva e standardeve ndërkombëtare;
- » Kapitali rregullator si një gur themeli i procesit mbikëqyrës;
- » Faktorët alarmues për ndërhyrjen e mbikëqyrësve dhe masat mbrojtëse për të siguruarit dhe stabilitetin financiar;
- » Zbatimi dhe vlerësimi i standardeve të IAIS-it;
- » Mbikëqyrja me bazë rrisht në praktikë e ilustruar me shembuj nga vende të ndryshme.

Temat e trajtuara gjatë seminarit u fokusuan në përmbledhjen e parimeve bazë të sigurimeve të IAIS-it (*Insurance Core Principles, ICP*), aktivitetet e fundit të vendosjes së standardeve, kërkesat e kapitalit rregullator dhe burimet e kapitalit, kërkesat e kapitalit për grupe të caktuara, identifikimi i hershëm dhe korigjimi i problemeve, përmbledhjen e tipeve dhe metodologjive të vlerësimeve, zbatimin dhe vlerësimin e standardeve të IAIS-it me anë të vetëvlerësimeve dhe *peer reviews*.

Seancat e ndryshme kishin si qëllim t'i ofronin pjesëmarrësve një kuptim më të madh të këtyre temave nga ana teorike dhe praktike, duke përfshirë dhe demonstrimin e eksperiencës së lektorëve në fushën e sigurimeve dhe raste studimore për tema të veçanta.

## Seminar mbi zbatimin parimeve të IOSCO-s

Në datat 27-28 tetor, në Zyrë, Zvicër u zhvillua seminari i 8-të trajnues i Komitetit Konsultativ të anëtarëve vëzhgues të IOSCO-s (*Affiliate Members Consultative Committee, AMCC*) me temë "Zbatimi i parimeve të IOSCO-s". Seminari u organizua si bashkëpunim midis Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Letrave me Vlerë (IOSCO), Autoritetit Mbikëqyrës të Tregjeve Financiare të Zvicrës dhe Autoritetit të Tregjeve Financiare dhe Letrave me Vlerë (ANBIMA). Në seminar mermin pjesë rreth 134 pjesëmarrës nga vende të ndryshme të botës, përfaqësues të IOSCO-s, si dhe zyrtarë të lartë nga autoritetet rregullatore të Zvicrës, Anglisë, SHBA-së, Bankës së Anglisë, etj.

Në konferencë u trajtuan çështje të rëndësishme me karakter global të mbikëqyrjes së tregut të letrave me vlerë si:

- » Tendencat e fundit në identifikimin e abuzimit të tregut dhe qasje të reja për mbikëqyrjen e tregut;
- » Elementët kryesorë për një sistem të shëndoshë të mbikëqyrjes me bazë risku;
- » Trajtimi i konfliktit të interesit.

Një vend të rëndësishëm në seminar zuri edhe trajtimi i çështjeve që lidheshin me zhvillimet e fundit në sigurinë kibernetike dhe roli i rregullatorëve në trajtimin e kësaj çështjeje, nisur nga rritja e vazhdueshme e kërcënimeve të sigurisë kibernetike. Siguria kibernetike, veçanërisht në tregun e letrave me vlerë, ka filluar të tërheqë vëmendjen e rregullatorëve, pjesëmarrësve të tregut dhe IOSCO-s. Në seminar u theksua rëndësia e përbaljes me këto kërcënime, që nëse nuk do të vihen në kontroll, mund të kenë pasoja jo vetëm për tregun financiar, por për të gjithë ekonominë.

Raste të ndryshme studimore u prezantuan në seminar nga ekspertë të fushës, si edhe u zhvilluan diskutime të eksperiencave në grupe të veçanta pune.



## Konferencë mbi rritjen e kapaciteteve për mbrojtjen e konsumatorit

Instituti i Studimeve Financiare të Rumanisë, me mbështetjen e Organizatës Evropiane të Instituteve Kombëtare për Edukimin në Sigurime (*EFICERT*), zhvilluan më 7-9 tetor në Bukuresht, Rumania konferencën mbi rritjen e kapaciteteve për mbrojtjen e konsumatorit. Konferenca e këtij viti diskutoi për mundësitë dhe vështirësitë e hasura nga zbatimi i direktivës, MiFID II (*Market in Financial Instruments*) dhe kërkesat e shtruara për edukimin dhe mbrojtjen e konsumatorit.

Në të merrnin pjesë përfaqësues të instituteve kombëtare të tregut të sigurimeve nga vende evropiane, me qëllim shkëmbimin e ideve dhe zhvillimin e “gjuhës së përbashkët” në çështjet e edukimit në tregun e sigurimeve.

Tregjet e sigurimeve kudo po përballen me direktiva, të cilat kanë edukimin në përmbajtje, sidomos pas daljes së rregulloreve të reja si MiFID II dhe IDD. Në interes të mbrojtjes së konsumatorit janë shtuar kërkesat për kualifikime profesionale dhe për edukim në vazhdim. Kurrikulat e sistemeve arsimore ndryshojnë shumë nga njëri vend në tjetrin dhe kjo e bën më të vështirë përcaktimin e standardeve të përbashkëta.

Në konferencë u diskutua dhe u shkëmbyen përvojat më të mira në edukimin dhe mbrojtjen e konsumatorit.

## Konferencë mbi edukimin dhe mbrojtjen e investitorëve: Sfidat kryesore që hasen përpara

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (*International Organization of Securities Commissions, IOSCO*), zhvilloi më 20-23 tetor në Madrid, Spanjë konferencën "Edukimi dhe mbrojtja e investitorëve - sfidat kryesore që hasim përpara". Pjesëmarrës në konferencë ishin përfaqësues nga rregullatorë të ndryshëm të vendeve që janë anëtarë të IOSCO-s. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë, është anëtar me të drejta të plota në këtë organizatë që prej vitit 2009.

Referues në konferencë ishin trajnerë nga rregullatorë të ndryshëm si edhe profesorë në disa universitete si *New York Law School* dhe *George Washington University*. Gjithashtu në konferencë referuan edhe përfaqësues të organizmave ndërkombëtare si IOSCO, Komisioni i Letrave me Vlerë i Sh.B.A-së (*U.S. Securities and Exchange Commission, U.S. SEC*), ESMA (*European Securities and Markets Authority*), CVM Brazil (*Securities and Exchange Commission, Brazil*), OECD (*Organisation for Economic Cooperation and Development*), etj.

Në konferencë u prezantuan edhe rezultatet e një anketimi të organizuar nga Gallup mbi edukimin financiar. Përfaqësuesit e Gallup prezantuan mënyrën se si ishte ndërtuar anketimi, rezultatet e marra dhe si mund të përdorëshin ato për riformatimin e programeve edukuese nga rregullatorët në tregun e letrave me vlerë.

Ndër temat e tjera të trajtuara ishin:

- » Mbrojtja e investitorëve dhe roli i konkurrencës në sigurimin e çmimeve më të mira për investitorët;
- » Ndikimi i edukimit financiar në zvogëlimin e mashtrimit në tregje;
- » Krimi kibernetik dhe sfidat e reja të tregjeve;
- » Roli i rregullatorëve në hartimin dhe zbatimin e programeve edukuese për investitorët;
- » Bashkëpunimi me sektorin privat në edukimin e investitorëve;
- » Menaxhimi i ankesave nga investitorët, mundësitë alternative të negociimit, arbitrazhit dhe ndërmjetësimit.

Në konferencë u paraqitën edhe raste studimore nga vende të ndryshme të botës lidhur me kursimet afatgjata. Disa nga tematikat në konferencë u realizuan nëpërmjet pjesëmarrjes aktive të audiencës.

# LAJMET NGA RAJONI

## AZERBAJXHAN

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Në tremujorin e tretë të vitit 2015, primet e shkruara bruto të mbledhura nga kompanitë vendase arritën në 339.26 milionë AZN, (monedha lokale) ose rreth 299 milionë euro. Kjo është një rritje prej afro 8% e shprehur në terma vjetorë. Sipas të dhënave të paraqitura nga Ministria e Financave e Republikës së Azerbajxhanit, gjatë kësaj periudhe, primet e shkruara bruto për segmentin e Jo-Jetës u rritën me 5.43%, ndërsa ato të sigurimit të Jetës u rritën me 15.95% në terma vjetorë.

Grupet me rritje më të ndjeshme ishin primet e shkruara bruto për sigurimin e anijeve, të cilat u rritën me 319.55% dhe për sigurimin e pronave të paluajtshme, me rritje 64.08%. Kjo rritje është kryesisht pasojë e projekteve të mëdha infrastrukturore të vendit që stimulojnë zhvillimin e industrisë së sigurimeve në tërësi.

## KROACI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas statistikave paraprake të publikuara në faqen e Internetit të Byrosë Kroate të Sigurimeve (Croatian Insurance Bureau), siguruesit kroatë, në nëntë muajt e parë të vitit 2015, arritën një vlerë totale të primeve të shkruara bruto prej 6.72 miliardë HRK (monedha lokale), afro 881 milionë euro. Kjo është një rritje prej afro 2.43% e përlogaritur në terma vjetorë. Primet e shkruara bruto të sigurimit të Jo-Jetës pësuan një ulje me 2.65% në terma vjetorë, ndërsa segmenti i sigurimit të Jetës u rrit me 15.04% duke arritur në rreth 217 miliardë HRK.

Në fund të shtatorit 2015, tregu kroat i sigurimeve kishte 25 sigurues aktivë në treg.

## MOLDAVI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të publikuara nga Komisioni Kombëtar i Tregut Financiar të Moldavisë, në gjysmën e parë të vitit 2015, primet e ndërmjetësuara nga kompanitë vendase të brokerimit në sigurime u rritën me 13% në terma vjetorë, duke arritur në 179.35 milionë MDL (monedha vendase), ose rreth 8.28 milionë euro.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2015, 94.1% e shitjeve nga ndërmjetësit u realizua në segmentin e sigurimit të Jo-Jetës dhe pjesa tjetër në sigurimin e Jetës. Numri i kontratave të sigurimit të lidhura është rritur, duke arritur në 169,260 krahasuar me 147,277 që ishte gjatë gjysmës së parë të vitit 2014.

Në tregun lokal të sigurimeve veprojnë 72 kompani brokerimi, 10 më pak se në gjysmën e parë të vitit 2014.

# EDUKIMI I KONSUMATORIT

## “E ardhmja e tregjeve të kapitalit në ekonominë dixhitale”

*Fjala e mbajtur nga Greg Medcraft, Kryetar i Komisionit Australian të Letrave me Vlerë dhe Investimeve (Australian Securities and Investments Commission) me studentë dhe pedagogë në Universitetin Carnegie Mellon në Adelaide, Australia, 16 shtator 2015. Z. Greg Medcraft është gjithashtu edhe Kryetar i Bordit të Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) e cila mbledh së bashku rregullatorë të tregut nga më shumë se 120 juridiksione, të cilat përfaqësojnë mbi 90% të vlerës së tregjeve të kapitalit në botë.*

*Në fjalën e tij ai flet specifikisht për tre çështje: (i) Disa nga ndryshimet që sjellin teknologjitë dixhitale në modelet ekzistuese të biznesit; (ii) Mundësinë që këto zhvillime kanë për tregjet kapitale ashtu siç i njohim ato, duke ju referuar në mënyrë të veçantë emergjencës së teknologjisë së bazës së të dhënave; (iii) Mënyrën se si mund të përgjigjen rregullatorët.*

*(Pjesa e parë – marrë me shkurtime)*

Mesazhi im kryesor sot është që ndryshimet dixhitale kanë një potencial mjaft të madh për të rikonfiguruar dhe për të përmirësuar në mënyrë radikale efikasitetin e tregjeve të kapitalit global. Besoj se kjo do të ndodhë pasi ndryshimet dixhitale do t'u japin investitorëve dhe bizneseve që kërkojnë kapital, akses më të drejtpërdrejtë, më të menjëhershëm dhe më të lirë tek njëri-tjetri. Dhe ajo çfarë nënkuptojmë me këtë, ne si rregullatorë, është rikonfigurimi i paketës së mjeteve tona për përdoruesit finalë të tregjeve tona, bizneset dhe investitorët, dhe mënyra sesi veprojnë ata. Duke pasur parasysh shpejtësinë e ndryshimit, ne duhet të mendojmë për atë paketë mjeteve që tani.

Përpara se të vijoj në mënyrë më të detajuar me shpjegimin e këtyre ideve, më lejoni fillimisht që t'ju përshkruaj shkurtimisht historikun e Komisionit Australian të Letrave me Vlerë dhe investimeve (*Australian Securities and Investments Commission, ASIC*), prioritetet tona, sfidat me të cilat përballemi dhe mënyra se si i përmbushim ato.

### Historiku i ASIC

Roli i ASIC në Australi është ai i rregullatorit të aktiviteteve në tregjet e shërbimeve financiare dhe kjo mbulon jo vetëm shkëmbimet dhe tregjet tona të ndryshme, por edhe ata që zhvillojnë, shesin dhe këshillojnë mbi investimet dhe produktet e kreditimit. Ne monitorojmë drejtimin e këtyre “portierëve” (kontrollorëve të aksesit) dhe ndërmarrim veprime duke përfshirë veprime përforcuese të zbatueshmërisë, kur zbulojmë sjellje jo të duhur në treg.

Ajo çfarë na nxit, është që tregjet, të cilat ne i rregullojmë, të funksionojnë për të financuar ekonominë e vërtetë dhe të nxisin zhvillimin ekonomik. Duke vepruar në këtë mënyrë, ne kontribuojmë për përmirësimin e standardeve të jetesës për të gjithë australianët. Por, ne mund t'i arrijmë të gjitha këto, nëse

investitorët, konsumatorët financiarë dhe ata që kanë nevojë për kapital për të ndërtuar bizneset e tyre, kanë besim në tregjet tona të kapitalit.

Kjo reflektohet në dy prioritetet tona strategjike rregullatore:

- » Besimi i investitorit dhe konsumatorit;
- » Tregje të ndershme, të rregullta, transparente dhe efikase.

Dua të flas shkurtimisht për sfidat me të cilat përballemi për të ruajtur dhe përmbushur këto prioritetet.

## Sfidat për besimin e investitorëve

Shohim një sërë sfidash që mund të kërcënojnë besimin dhe konfidencën e investitorit në tregjet tona. Këto sfida janë ato të cilat nxisin punën që ne bëjmë aktualisht:

- » Arritja e balancës së duhur ndërmjet një sistemi të bazuar në tregun e lirë dhe mbrojtjen e investitorit;
- » Ndryshimet dixhitale në sektorin e teknologjisë financiare (*fintech*) siç janë huadhënia, këshillimi financiar në Internet, financimi i projekteve duke mbledhur të ardhura nga shumë burime, monedhat dixhitale dhe infrastruktura të tjera pagesash. Gjatë viteve të fundit, ka pasur rritje të konsiderueshme në numrin dhe shkallën e sulmeve kibernetike kudo në botë;
- » Komplexiteti që nxitet nga risitë financiare në produkte, tregje dhe teknologji. Një pjesë e madhe e kësaj nxitet nga dixhitalizimi i ekonomisë sonë;
- » Globalizimi, i cili prek gjithashtu produktet, tregjet dhe teknologjinë;
- » Ndryshimin strukturor në sistemin tonë financiar, i cili po ndodh përmes rritjes së tregjeve të kapitalit të nxitura nga:

- Faktorët e ofertës, siç janë lëvizja e kursimeve nga sektori bankar në sektorët e tregjeve të tjera financiare. Kjo gjë nxitet pjesërisht nga ndryshimet vjetore të detyrueshme, por gjithashtu edhe nga plakja e popullsisë;

- Faktorët e kërkesës, siç janë rritja e kostos për fonde ose reduktimi i disponueshmërisë nga sektori bankar, si rezultat i kriterëve të reja për likuiditetin bankë-kapital, të cilat po i shtyjnë akoma më shumë bizneset që të kërkojnë financime në tregje.

## *Behavioural economics* - Ndikimi i qëndrimit individual në vendimet e lidhura me ekonominë

Mënyra se si i përgjigjemi në këtyre sfidave ndikohet gjithnjë e më shumë nga qëndrimet individuale, faktorët psikologjikë, socialë, emocionalë, etj. (*behavioural insights*).

Njohja e qëndrimeve individuale na ndihmon që të kuptojmë se në vendimet e përditshme, duke përfshirë vendimet financiare, të gjithë ne, investitorët dhe konsumatorët financiarë, influencohemi nga preferencat personale, besimi dhe mënyrat e shpejta të vendim-marrjes. Kjo mund të ketë efekte të rëndësishme në tregjet financiare dhe të kreditimit, ku kompleksiteti, risku, pasiguria dhe natyra afatgjatë e produkteve financiare mund t'i theksojnë këto paragjykime në sjellje.

Njohja e sjelljes së investitorëve dhe atyre që kontrollojnë aksesin në tregje, mund të ndihmojë ASIC të sigurojë nxitjen e duhur, të influencojë qëndrimin e tyre, për të arritur prioritetet tona strategjike.

## Ndryshimet që sjell veçimi dixhital (*digital disruption*) <sup>1)</sup>

Rregullatorët po përballen me sfida të reja në nivel global, të cilat kanë ardhur nga ndryshimi strukturor dhe veçimi dixhital. Ekzistojnë mundësi por edhe sfida. Çështja qëndron në shfrytëzimin e mundësive, ndërkohë që zbuten risqet. Unë besoj se veçimit dixhital sjell mundësi. Tashmë nuk janë risi përdorimet e kartave të kreditit dhe ATM-ve, të cilat u zhvilluan nga bankat për të lehtësuar aksesin e klientit. Tani zhvillimet e reja po shkojnë përtej sistemit bankar, në mënyrë të drejtpërdrejtë tek klienti. Bizneset kanë parë mundësinë për mënyra të reja të krijimit dhe shpërndarjes së drejtpërdrejtë të vlerave tek investitorët dhe konsumatorët me njohuri të mira teknologjike. Siç e përmenda më parë, shembujt përfshijnë: (i) huadhënien individuale dhe tregun e dhënies hua (*peer-to-peer lending and market-place lending*); (ii) këshillimin financiar dixhital (*robo-financial or digital advice*); (iii) financimin nga masat në shuma të vogla (*crowdfunding*); (iv) infrastrukturën e pagesave (p.sh. monedhat dixhitale, Apple Pay).

Në të ardhmen, ka shumë mundësi që të shohim zhvillime të mëtejshme në tregun e sigurimeve, me çmime të cilat reflektojnë njohjen më të thellë të karakteristikave individuale të riskut në produktet e sigurimit, siç mund të jenë sigurimi i shtëpisë, i Jetës dhe i automjeteve.

Të gjitha këto risi kanë potencialin për të ndryshuar mënyrën si ndërveprojnë investitorët dhe konsumatorët financiarë me produktet financiare dhe pagesat. Por, shumë nga këto aktivitete mund të mos përshtaten brenda kuadrit ose politikës rregullore ekzistuese. Sfidat për ne do të jetë të vazhdojmë të ruajmë prioritetet që përmenda më lart, besimin e investitorëve dhe konsumatorëve dhe mbështetjen për tregje të pastra, të rregullta, transparente dhe efikase përballë këtyre zhvillimeve.

*Vijon në numrin e ardhshëm ...*

1) Digital disruption i referohet ndryshimeve të sjellja nga teknologjitë dixhitale që ndodhin në një ritëm dhe forcë të tilla që veçojnë dhe ndryshojnë mënyrat e vendosura më parë të krijimit të vlerave, ndërveprimit social mënyrës së bërjes së biznesit dhe në tërësi mënyrën tonë të të menduarit.